

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – sherbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Mirembajtje (furnizim vendosje) automjetet e Shoqerise ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Pjesë këmbimi për automjete, furgonë dhe makina transporti mallrash__34330000-9

VLERA E FONDIT LIMIT:

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. I ndryshuar

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pike plotësohet me Formularin e vetedeklarimit

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet 2022,2023,2024, ku vlera e perlllogaritur duhet të jete jo me e vogel se 596 242(Peseqind e nentedhjet e gjashte mije e dyqind e dyzet e dy) leke pa tvsh (40%)te vleres se parashikuar te kontrates..
- Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë **arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar** nga autoriteti/enti kontraktor”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 55, pika 4, ”Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”. Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa c), për procedurat nën kufirin e ulët monetar, siç është rasti i kësaj procedure.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM ”Për rregullat e prokurimit publik”, e cila parashikon se Autoriteti koonraktor për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike mund të kërkojë për një periudhë maksimumi deri në 3 vitet e fundit financiare. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore)

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë bilancet vjetore, për 3 vitet(2022,2023,2024) e fundit financiare të certifikuar nga organet tatimore, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenin 41, të ligjit Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshur “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare*”, përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese. Si dhe Ligjin nr 8438 dt 28.12.1998 “Per Tatimin mbi te ardhurat” i ndryshuar ,ku theksohet ”Cdo tatim pagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuara ne Udhëzimin e Ministrisë të Financave ne zbatim te ketij ligji.Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore ne organet tatimore brenda dates 31 mars te vitit pasardhes.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2024 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” I ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer shërbime të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se 298 121 (dyqind e nentëdhjet e tete mijë e njëqind e njëzetë e një) lek pa tvsh (20%) të vlerës së fondit të limit të kontratës të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë; **a)** Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara, **b)** Për shërbime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas

kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvorjen e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda vlerës limit të kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik, duke qenë një kontratë e rëndësishme, mbështetur në sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt prokurimi. Kjo kërkesë i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvorjen që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një “kompetencë thelbësore”, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të punësuar në funksion të realizimit të objektit të prokurimit të paktën 2(dy) punonjës, për muajin e fundit nga data e zhvillimit të procedurës

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të disponojnë:

Formularët E- SIG për periudhën muajin e fundit data e zhvillimit të procedurës

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Ky numër minimal është kërkuar duke u bazuar në numrin e automjeteve në të cilat do të kryhen shërbimet si dhe natyrën dhe numrin e shërbimeve që kërkohen.

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë minimalisht mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- 1 (një) urë ngritëse me kapacitet ngritës sipas nevojave të mjeteve që do të riparohen.
- 1 (një) pajisje për kontrollin dhe testimin/diagnostifikimin e difekteve elektronike të automjeteve.
- 1 (një) pajisje për kontrollin dhe testimin e sistemit të frenimit të automjeteve.

- 1 (një) pajisje për kontrollin dhe testimin e sistemit të amortizimit të automjeteve.
- 1 (një) pajisje për kontrollin dhe testimin e difekteve në sistemin e drejtimit.
- 1 (një) pajisje për kontrollin dhe komprimimin e gazit të A/C.

Për mjetet dhe pajisjet e mësipërme, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentat që vërtetojnë se, këto mjete dhe pajisje i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (*faturo blerje/dokumente zhdoganimi/kontrata qiraje/kontrata huapërdorje/ kontrate dhurimi/çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë*)

Argumentimi : Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë shërbimet për riparimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve, të cilat duhet të realizohen sipas specifikimeve teknike, duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, makinerinë e përcaktuar më sipër. Ky kriter është vendosur, gjithashtu edhe për arsye se është çmuar si e nevojshme zotërimi i këtyre pajisjeve specifike, të konsideruar nga AK si të domosdoshme për realizimin e shërbimit. Referuar natyrës së objektit të prokurimit për realizimin me sukses të shërbimeve është e nevojshme pajisja e këtyre pajisjeve.

Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon të paktën 1 (një) ambjent/servis ku ushtron veprimtarinë, për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

Dokumenta që vërtetojnë se këtë ambjent e ka në pronësi ose me qera ose kontrate bashkepunimi me një servis .

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion ambjentin për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se kemi të bëjmë me furnizim dhe vendosje shërbimi që ofrohet objekt i kësaj kontrate është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, të cilat duhet të dërgohen në ambjentet e servisit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor është e domosdoshme që operatorët ekonomik duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, 1 (një) ambjent ku ushtron aktivitetin e tij me qëllim realizimin të objektit të prokurimit.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim që në rast defekti i cili shkakton teknikisht pamundësinë e lëvizjes vetë të automjeteve të autoritetit kontraktor do të vërë në dispozicion pa pagesë automjet të specializuar për transportin e automjeteve të difektuara, (Karroatrec), për transportimin e automjeteve të difektuara nga ambjentet e autoritetit kontraktor deri në servisin e kontraktuesit. Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumenta që vërtetojnë se ka karroatrec në pronësi ose me kontrate me qera ose me kontrate shërbimi.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin

Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, ndër të cilat mund të ndodhë që në raste të caktuara duhet të transportojnë një automjet të difektuar në ambjentet e servisit që disponon operatori ekonomik kontraktues, është e domosdoshme që operatorët ekonomikë ofertues duhet të dëshmojnë që vënë në dispozicion me shpenzimet e veta minimalisht, 1 (një) automjet karrotrec me qëllim realizimin të objektit të prokurimit.

Operatori ekonomik duhet të deklarojë se pjesët e këmbimit që do të perdoren duhet të ofrohen të reja, prodhim sipas CE dhe me garanci jo më pak se 1 vit nga data e montimit (furnizim-vendosje)

Argumentimi: Në bazë të nenit 41, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë aftësitë për të realizuar me sukses dhe sipas kriterëve riparimin e automjeteve.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë që merr për sipër riparimin dhe mirëmbajtje (Difekte) të automjeteve që janë në shërbim 24/24 orë në çdo vend që ndodhë difekti, gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës

Argumentimi: Në bazë të nenit 41, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë aftësitë për të realizuar me sukses dhe sipas kriterëve riparimin e automjeteve. Në funksion të realizimit me sukses të detyrave të tij, Autoriteti Kontraktor, disponon rreth 15 automjete transporti, tipologjia dhe larmia e të cilave varion që nga kamionçinat, kamionë me akse të ndryshme, Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje të plotë me kërkesat që ka çdo mjet sipas tipologjisë, vitit të prodhimit, kilometrave të përshkuara dhe/ose orëve të punës, me qëllim dhënien e një informacioni sa më të plotë për çdo mjet me qëllim kryerjen dhe sigurimin e një shërbimi cilësor të mjeteve të AK-së.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm, i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve të teknike në përputhje me nenin 36, të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Në funksion të realizimit me sukses të detyrave të tij, Autoriteti Kontraktor, disponon rreth 15 automjete transporti, tipologjia dhe larmia e të cilave varion që nga kamionçinat, kamionë me akse të ndryshme, Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje të plotë me kërkesat që ka çdo mjet sipas tipologjisë, vitit të prodhimit, kilometrave të përshkuara dhe/ose orëve të punës, me qëllim dhënien e një informacioni sa më të plotë për çdo mjet me qëllim kryerjen dhe sigurimin e një shërbimi cilësor të mjeteve të AK-së.

Komisioni